

**REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT  
РЕПУБЛИКА СЕВЕРНА МАКЕДОНИЈА**

**UNIVERSITETI “NËNË TEREZA” NË SHKUP  
УНИВЕРЗИТЕТ „МАЈКА ТЕРЕЗА“ ВО СКОПЈЕ**



**УНИВЕРЗИТЕТСКИ ГЛАСНИК  
INFORMATORI UNIVERSITAR**

**Nr. / Бр.15-1/2023**

**Shkup, DHJETOR 2023**  
**Скопје, ДЕКЕМВРИ 2023**

**Botim i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup**  
**Издание на Универзитетот „Мајка Тереза“ во Скопје**

Redaktor i veprimtarisë botuese të UNT-së/ Уредник на издавачката дејност на УМТ:  
Prof.dr.Izet Zeqiri, rektor / Проф. д-р Изет Зекири, ректор

Redaktor i Informatorit / Уредник на гласникот:  
Prof.dr. Mustafa Ibrahim / Проф. д-р Мустафа Ибрахими  
Mr. Bujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

Këshilli redaktues / Уредувачки одбор:  
Prof.dr. Mustafa Ibrahim / Проф. д-р Мустафа Ибрахими  
Prof. dr. Rizvan Sulejmani / Проф. д-р Ризван Сулејмани  
Prof. Inor. dr. Fati Iseni / Вонр. Проф. д-р Фати Исени  
Mukades Hajdari / Мукадес Хајдари

Rregullimi teknik / Техничко уредување  
Mr. Bujar Kajolli / М-р Бујар Кајоли

## PËRMBAJTJA/SODRZHINA

1. Програма за работа на кандидатот за декан на Правниот факултет вонр. проф. д-р Аргтим Салиу / Programi i punës i kandidatit për dekan të Fakultetit Juridik prof. inor. dr. Argëtim Saliu ----- 6 - 15
2. Програма за работа на кандидатот за декан на Економскиот факултет вонр. проф. д-р Букурие Имери Јусуфи / Programi i punës i kandidatit për dekan të Fakultetit të Ekonomik prof. inor. dr. Bukurie Imeri Jusufi ----- 16-23
3. Програма за работа на кандидатот за декан на Факултетот за хуманистички науки проф. д-р Мустафа Ибрахими / Programi i punës i kandidatit për dekan të Fakultetit të Shkencave Humane prof. dr. Mustafa Ibrahimî -----



**FAKULTETI JURIDIK**

# **PLAN-PROGRAMI**

**për punën e dekanit 2023-2026**

Kandidati: Prof. inord. Dr. Argëtim Saliu

Shkup,  
14.11.2023

## **Drejtuar anëtarëve të Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Juridik**

**Të nderuar kolegë, Profesorë,**

Kam nderin të prezantoj kandidaturën time për postin e dekanit në Fakultetin Juridik. Ky program i propozuar është një përpjekje për të shprehur idetë dhe synimet e mia për zhvillimin e Fakultetit Juridik në tre vitet e ardhshme. Programi është gjithëpërfshirës, por mbi të gjitha ne si KMSH do të jemi të hapur për të gjithë dhe gjithashtu të gjitha sugjerimet dhe idetë do të jenë të mirëseardhura.

Programi i propozuar është i përpiluar dhe i hartuar sipas kapaciteteve, dëshirave dhe ambicioneve tona të përbashkëta. Duke marrë parasysh atë se të gjithë ne jemi pjesë e komunitetit akademik, nisem nga fakti gjithashtu se zhvillimi i Fakultetit Juridik do të varet dhe do të zhvillohet duke u përfshirë të gjithë ne. Por, gjithashtu, duhet nënvizuar faktin se do të vazhdoj të mbroj dhe të punoj në bazë të dispozitave ligjore, rregullore si dhe autonomisë akademike, duke vlerësuar përkushtimin në punë dhe dëshirën për bashkëpunim.

Nga këtu gjithashtu duhet nënvizuar respektin dhe kujdesin e sinqertë për kolektivin, punonjësit, transparencën, mbështetjen reciproke, etj. Poashtu besoj që vetëm të bashkuar dhe së bashku do të arrijmë të realizojmë programin si dhe të forcojmë dhe të sigurojmë rrugën e zhvillimit dhe suksesin e Fakultetit Juridik.

**Me respekt,**

Prof. Inord. Dr. Argëtim Saliu d.v.

**Shkup, 14.11.2023**

## **Përmbajtja:**

I.	HYRJE	9
	.....	9
1.	Vazhdimësia e procesit arsimor (organizimi dhe përmirësimi i mësimdhënies)	10
	.....	10
1.1	Shqyrtimi i programeve studimore aktive të Fakultetit dhe propozime për programe të reja studimore	11
	.....	11
2.	Puna shkencore-kërkimore dhe puna me projekte në Fakultetet	12
	.....	12
3.	Përfshirja e studentëve në aktivitete (duke bërë lidhjen mes fakulteteve dhe universitetit)	13
	.....	13
4.	Marrëdhëniet me publikun dhe promovimi i fakultetit	13
	.....	13
5.	Aktivitete të tjera shtesë	14
	.....	14
II.	PËRFUNDIM	15
	.....	15

Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.82/18) dhe në pajtim me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, kandidati Assoc.Prof. Dr. Argëtim Saliu propozon këtë:

### **Program për punë të dekanit të Fakultetit Juridik pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në periudhën e mandatit 2023-2026**

#### **I. HYRJE**

Roli dhe rëndësia e pozitës së dekanit të Fakultetit Juridik në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup duhet thënë se është një pozitë e nderuar dhe prestigjioze, kryerja e së cilës kërkon nivel të lartë të përgjegjësisë dhe ndërgjegjes, si dhe punë me përkushtim në zhvillimin dhe përparimin e aktiviteteve të Fakultetit si dhe profesionalizëm gjatë kryerjes së detyrave dhe punëve.

Gjithashtu detyra e dekanit paraqet një mundësi për koordinim dhe menaxhim të një sistemi kompleks, i cili bazohet në parimet e bashkëpunimit të mirë akademik me të gjithë punonjësit e Fakultetit. Poashtu duhet nënvizuar faktin se sukcesi i punës së dekanit është i mundur vetëm përmes bashkëpunimit dhe kontributit të përbashkët, të ndershëm, të ndërgjegjshëm dhe të sinqertë nga të gjithë punonjësit e Fakultetit.

Parimet themelore që do t’i ndjekim së bashku synojnë një respekt të veçantë për çdo punonjës që ka ide kreative, mendime dhe vizion për zhvillim. Aplikimi i mësimdhënies cilësore bazuar në njohuritë shkencore, zhvillimi i shkencës, raporti i favorshëm profesor-student (rritja e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërveprues), mësimi interaktiv, avancimi i metodave së mësimdhënies, vizitat në terren dhe vendosjet praktike, janë pjesë e detyrave dhe aktiviteteve me të cilat do të punoj aktivisht së bashku me grupin tim gjatë periudhës së mandatit. Gjithashtu, një rol të rëndësishëm do t’i kushtohet edhe zhvillimit të mësimdhënies si dhe veprimtarisë kërkimore-shkencore të Fakultetit Juridik, ku theksi duhet vënë në:

- ❖ Vazhdimësinë e procesit arsimor, përmes promovimit dhe avancimit të të gjitha segmenteve që janë karakteristikë e një institucioni të lartë arsimor;
- ❖ Furnizimin me pajisje, modernizim dhe zgjerim të kapaciteteve të klasave të mësimdhënies si dhe laboratorëve të ndryshëm;
- ❖ Modernizimin, thellimin dhe ndërkombëtarizimin e veprimtarisë kërkimore-shkencore;
- ❖ Kujdesin për studentët dhe përfshirjen e tyre në të gjitha nivelet e veprimtarisë së Fakultetit Juridik.

Shpresoj që me realizimin e këtij program, Fakulteti ynë në një të ardhme të afërt do të bëhet një brend i njohur për shoqërinë, ku do të mund të regjistrohen studentë nga të gjitha nacionalitetet, si nga vendi poashtu edhe nga jashtë.

## **1. Vazhdimësia e procesit arsimor (organizim dhe përmirësim i mësimdhënies)**

Misioni dhe qëllimi i themelimit të Fakultetit Juridik pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup është që të ofrojë arsim të bazuar në arritjet shkencore dhe profesionale nga fusha e shkencave juridike.

Si dekan i ardhëm do të angazhohem për avancimin e veprimtarisë themelore të Fakultetit për të cilin është themeluar, e kjo ka të bëjë me edukimin e drejtimit të Juridik duke përfshirë këtu disa drejtime dhe programe të tjera studimore, si dhe të mundësojë përvetësimin e aftësive dhe njohurive praktike, me të cilat juristët e ardhshëm në shkencat juridike do të profilizohen dhe do të jenë në gjendje të gjejnë zgjidhje për problemet e fushave juridike.

Për përmirësimin e mësimdhënies, rëndësi më e madhe është që lëndët të shpërndahen sipas profesionalizmit dhe kompetencës së të gjithë anëtarëve të stafit akademik të Fakultetit. Gjithashtu, do të përqipem që mësimi të shpërndahet proporcionalisht mes të gjithë anëtarëve, në mënyrë që të gjithë të kenë përafërsisht numrin e njëjtë të orëve. Do të mundohem që të angazhojmë kuadër të ri shtesë, i cili do të forcojë kapacitetet e Fakultetit dhe kështu do të mund të mbulojmë me sukses të gjitha programet studimore. Sigurimi i klasave dhe laboratorëve të rinj do të jetë gjithashtu prioritet. Sigurimi i literaturës dhe librave të përshtatshëm do të jetë gjithashtu i një rëndësie të madhe për Fakultetin.

Gjatë mandatit si dekan i ardhshëm do të angazhohem që mësimdhënia të jetë më e fokusuar në aplikimin e rezultateve të të mësuarit, gjë e cila do të krijojë kompetenca që të ofrojnë njohuri funksionale bazuar në arritjet më të reja shkencore. Këto synime mund të arrihen vetëm me ndryshime në procesin mësimor dhe reformimin e tij në drejtim të mësimnxënies nëpërmjet zgjidhjes së problemeve, si dhe mësimdhënies nëpërmjet përfshirjes së studentëve në procesin e kërkimeve shkencore dhe punës praktike.

Gjithashtu do të angazhohem që procesi mësimor i Fakultetit Juridik të bazohet në një qasje holistike për studentët, të cilët pas diplomimit të kenë aftësi aplikimi të diturive të fituara, të mund të identifikojnë probleme dhe njëkohësisht për të ofruar zgjidhje për të njëjtat. Por, gjithashtu, ne duhet të punojmë që studentët tanë të marrin përgjegjësi dhe të sjellin vendime dhe të jenë në gjendje të mësojnë nga përvojat si dhe të demonstrojnë aftësi për të kuptuar këndvështrime të ndryshme. Do të angazhohemi poashtu që të gjitha këto që u përmendën më lart, të mundësohen duke aplikuar forma të ndryshme të mësimdhënies, siç është metoda e mësimit mentorial, punëtori interaktive me studentë, punime seminarike, e të tjera, të cilat duhet të jenë komponentë e detyrueshme për secilën temë në veçanti.

Profesorë të ftuar si mysafirë, profesorë vizitorë dhe persona ekspertë nga praktika mund të kontribuojnë ndjeshëm në ngritjen e mësimdhënies cilësore.


Do të angazhohem në mobilitetin sa më të madh të studentëve tanë dhe të stafit mësimor-shkencor në programe të ndryshme ndërkombëtare si ERASMUS+, CEEPUS,



etj, me synim të zbatimit të njohurive dhe përvojave të fituara gjatë procesit mësimor në Fakultetin e Shkencave Juridike.

Detyra e çdo profesori universitar, për të cilën do të angazhohem si dekan i ardhshëm, është që të përpiqet të arrijë dhe të transmetojë nivel të lartë njohurish në lëndën e tij, gjithashtu të sigurojë saktësi, precizitet, të përfaqësojë përmbajtjen e kurrikulës si dhe të zbatojë në tërësi atë që iu është dhënë paraprakisht studentëve, por njëherit edhe të kontribuojë në zhvillimin intelektual të studentëve duke ndihmuar në zgjidhjen e çështjeve komplekse në fushën e shkencave juridike.

Gjithashtu është shumë e rëndësishme të arrihet vlerësim i saktë dhe i besueshëm mbi njohuritë e studentëve dhe punën e tyre, i cili poashtu duhet të jetë i hapur, objektiv dhe në kohë.



**Fig 1. Organo-grami i Fakultetit Juridik**

### **1.1. Shqyrtimi i programeve aktive studimore të Fakultetit dhe propozime për programe të reja studimore**

Viti akademik 2023/2024 do të jetë viti i parë i studimeve në programet studimore pranë Fakultetit Juridik. Shpresojmë që çdo vit numri i studentëve që regjistrohen në

ciklin e parë të studimeve në Fakultetin Juridik vazhdimisht të jetë në rritje. Kjo mbi të gjitha për shkak të aktiviteteve promovuese të Fakultetit dhe programeve studimore: **Studimet e Drejtësisë dhe Kriminalistika** për të cilën studentët treguan interesim të madh.

Prandaj theksi kryesor duhet të drejtohet drejt përmirësimit të mësimdhënies, gjë që mund të arrihet duke rritur kapacitetet e klasave dhe laboratorëve, sigurimin e literaturës së përshtatshme për mësimdhënie, sigurimin e softuerëve të nevojshëm për mësimdhënie, por edhe punësime të reja të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve.

Fokusi i veçantë në vitet e ardhshme akademike do të jetë rifreskim i lëndëve mësimore e cila do të bëhet sipas përvojës dhe njohurive të stafit pedagogjik të Fakultetit Juridik, nevojave të tregut të punës si dhe mendimit të studentëve.

Sa u përket studimeve të ciklit të parë, Fakulteti ka në dispozicion këto programe studimore:

- Studimet e Drejtësisë (studime katërvjeçare);
- Kriminalistika (studime katërvjeçare);

Besoj që në të ardhmen, kuptohet me ndihmën dhe përvojën e stafit mësimdhënës, nevojave të tregut të punës, do të punojmë në akreditimin e programeve të reja atraktive studimore edhe në ciklin e parë, por edhe në ciklin e dytë.

## **2. Puna shkencore-kërkimore dhe puna me projekte në Fakultet**

Nisur nga fakti se shkenca është burim kryesor për identifikimin, ndërtimin dhe zhvillimin e njohurive, diturive të reja, konkrete dhe të përgjithshme mendoj se një rëndësi të veçantë duhet t'i kushtojmë edhe punës shkencore-kërkimore. Veprimtaria kërkimore-shkencore është i vetmi tregues për progresin e një institucioni të Arsimit të lartë, nëpërmjet të cilit do të përcaktohet vlerësimi (rejtingu) brenda shtetit, por edhe në suaza ndërkombëtare. Parametrat kërkimore-shkencore janë një formë e monitorimit të punës së stafit akademik.

Veprimtaria shkencore-kërkimore e Fakultetit Juridik ka filluar dhe po zhvillohet me një ritëm në rritje që nga themelimi i Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup. Një pjesë e stafit pedagogjik tanimë kanë marrë pjesë në projekte të ndryshme shkencore-kërkimore ndërkombëtare, gjithashtu janë pjesëmarrës në projekte hulumtuese ndërkombëtare-ERASMUS+, por njëkohësisht kanë publikuar edhe punime të pranueshme ndërkombëtarisht. Megjithatë, besoj që stafi pedagogjik i Fakultetit Juridik disponon me një potencial të madh të përvojave dhe njohurive të cilat mund të shfrytëzohen për veprimtari shkencore-kërkimore. Prandaj si dekan i ardhshëm do të angazhohem që Fakulteti Juridik, në fushën e veprimtarisë shkencore dhe kërkimore të sigurojë përparim edhe më të madh shkencor në nivel të vendit si dhe në atë ndërkombëtar.

Gjithashtu, si dekan i ardhshëm do të përpiqem të ndihmoj dhe ta mirëkuptoj çdo kolegë apo kolege që duhet të marrë pjesë në ndonjë konferencë apo për ndonjë qëndrim

studimor jashtë vendit, kurse ditët e humbur ta zëvendësojë paraprakisht ose mësimi të mbulohet në mënyrën e duhur.

Sa i takon pjesës së botimeve, brenda mundësive të tij Fakulteti Juridik do të mbështesë çdo anëtar që ka nevojë për ndonjë libër, softuer ose pajisje për të kryer ndonjë detyrë shkencore, si dhe do t'i kushtojmë rëndësi botimeve të librave dhe do të bëj gjithçka sa mundem që të përkrahen financiarisht nga Universiteti.

Në fund të kësaj pike si dekan i ardhshëm do të angazhohem që të arrihet një konkurrencë në mjedisin ndërkombëtar. Gjithashtu, është e nevojshme dhe e rëndësishme që të vijojmë me nënshkrimin e marrëveshjeve me fakultete dhe universitete të tjera me renome ndërkombëtare e botërore, kuptohet për bartjen dhe shkëmbimin e përvojave, zhvillimin e kurrikulave, mobilitetin e stafit akademik, etj.

### **3. Përfshirja e studentëve në aktivitete (duke krijuar njëkohësisht lidhje mes fakulteteve dhe Universitetit)**

Kuvendi studentor i Fakultetit Juridik është organ në të cilin anëtarë janë përfaqësuesit e studentëve. Kuvendi studentor nëpërmjet përfaqësuesve të tij të deleguar merr pjesë në Këshillin Mësimor Shkencor. Nga ana tjetër studentët janë pjesë përbërëse e Fakultetit Juridik. Nga këto arsye do të inkurajohen të gjitha aktivitetet studentore që synojnë përfshirjen e plotë në profesionet e Fakultetit Juridik, me theks të veçantë në projektet kërkimore, ngjarjet edukative dhe aktivitete të tjera.

Si dekan i ardhshëm do të angazhohem që të shtohen aktivitetet e kuvendit studentor. Bashkëpunimi me studentët do të promovohet mbi bazën e besimit të ndërsjellë. Gjithmonë do të respektoj mendimet dhe sugjerimet e studentëve, ndërsa bashkëpunimi me profesorët duhet të synojë drejt qëllimit të përbashkët për arritjen e nivelit më të lartë të cilësisë së studimeve. Gjithashtu, do të angazhohem që studentëve tanë t'ju siguroj klasa të përshtatshme, ku ata do të takohen periodikisht, do flasin dhe komunikojnë, por gjithashtu do të mbështes të gjitha vendimet që do të kontribuojnë në përmirësimin e jetës studentore.

Unë do të angazhohem edhe për një mobilitet (lëvizje) më të madh të studentëve në programet ERASMUS+, CEEPUS dhe të ndryshme, me qëllim që të përmirësojnë njohuritë dhe përvojat e tyre në fushën e shkencave juridike.

Si deri më tani, edhe në të ardhmen do të angazhohem që studentët më të dalluar të përfshihen në procesin mësimor si demonstratorë si dhe në veprimtarinë kërkimore-shkencore të Fakultetit Juridik.

Për të mundësuar një sistem studimi sa më efikas, do të angazhohem për hapjen e laboratorëve të rinj, zgjerimin e kapaciteteve të bibliotekës, rritjen e fondit të librave në bibliotekë si dhe qasje në faqet e ndryshme të bibliotekave ndërkombëtare.

Si dekan i ardhshëm do të angazhohem që së pari në suaza të fakultetit, por edhe në bashkëpunim me Universitetin të organizohet lloj të ndryshme në gara dhe konkurse nga

fusha e shkencave juridike, ku do të marrin pjesë studentët më të dalluar të drejtimeve përkatëse.

#### **4. Marrëdhëniet me publikun dhe promovimi i fakultetit**

Me qëllim të tërheqjes së studentëve të rinj, në bashkëpunim me zyrën për piar dhe organe të tjera të Universitetit, do të angazhohem në vazhdimin e aktiviteteve promovuese të Fakultetit Juridik, edhe atë duke përdorur disa forma të ndryshme të promovimit:

- Ditët e hapura të fakultetit, gjatë të cilave do të prezantohen programet e studimit, ku do të përfshihen një pjesë e studentëve si dhe stafi akademik;
- Hartimi i planit dhe strategjisë për të bërë prezantimin e Fakultetit dhe programeve studimore në të gjitha shkollat e mesme;
- Prezantimi online i programeve të studimit përmes platformës Google meet e të ngjashme;
- Shqyrtimi i mundësisë së zhvillimit të një plani dhe strategjie për tërheqjen e studentëve nga vendet fqinje dhe më gjerë.

Në bashkëpunim me organet e Universitetit do të angazhohem për ngritjen e një panairi karrierë, në të cilin do të ftohen të marrin pjesë kompani të njohura, ku studentët do të kenë mundësi të mësojnë për mundësitë e punësimit, ndërsa në të njëjtën kohë mund të prezantojmë edhe Fakultetin. Gjithashtu, në kuadër të aktiviteteve promovuese të Fakultetit, do të përpiqem të krijoj një “broshurë korporative për Fakultetin” në të cilën do të prezantohet portfoli i Fakultetit Juridik.

Gjithashtu, do të angazhohem të organizoj një konferencë vjetore donatorësh, në të cilën do të ftohen dhomat e tregtisë, komuniteti i biznesit, individë të përgjegjshëm shoqërorë, të cilët do të jenë të gatshëm të kuptojnë nevojën për t’u përfshirë në procesin arsimor përmes filantropisë dhe përgjegjësisë sociale. Qëllimi do të jetë të mbështeten financiarisht studentët me të ardhura të ulëta financiare ose të ndihmohet një aktivitet kërkimore-shkencor.

Do të përpiqem të siguroj trajnime për stafin mësimdhënës në bashkëpunim dhe të mbështetura nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Në fund, dua të theksoj se si dekan i ardhshëm, do të përpiqem të ruaj kontaktet e studentëve të diplomuar, përmes krijimit të një rrjeti të quajtur ALUMNI. Nëpërmjet këtij rrjeti do të mundësohet lidhja e të gjitha gjeneratave të Fakultetit dhe do të arrihet një bashkëpunim i vazhdueshëm i përbashkët, i cili do të mbështetet në themele të forta dhe do të kontribuojë në zhvillimin si të anëtarëve, poashtu edhe të vetë Fakultetit.

#### **5. Aktivitete të tjera shtesë**

Fakulteti Juridik, ashtu si i gjithë arsimit i lartë, përballë me mungesë serioze të stafit të ri mësimor-shkencor, bashkëpunëtorët, si dhe punonjësit në shërbimin administrativ

dhe personelin ndihmës teknik. Jam plotësisht i bindur se investimi në burime njerëzore është një investim kapital dhe mbetet një nga parakushtet themelore për realizimin me sukses të procesit arsimor dhe kërkimore-shkencor të Fakultetit Juridik.

Prandaj si dekan i ardhshëm do të angazhohem për një marrëdhënie proaktive në bashkëpunim me Universitetin, për të kërkuar mbështetje dhe ndihmë nga ministria përkatëse, në rradhë të parë nga ajo e Arsimit dhe e Financave, me qëllim të zgjidhjes së këtyre problemeve.

Gjithashtu do të ndihmoj në përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punë në ambientet e zyrave, përmirësimin e kushteve në klasa dhe laboratorë, si dhe rritjen e kapaciteteve të tyre.

Poashtu do të ndihmoj në përmirësimin dhe efikasitetin e funksionimit të shërbimit studentor, duke rritur kohën e shërbimit për studentët.

## **PËRFUNDIM**

Programi që e paraqes për zgjedhjen e dekanit të Fakultetit Juridik është një pjesë e planifikimit dhe aktiviteteve që do të ndërmarr së bashku me ekipin tim dhe KMSH-në. Ky plan program përfshin hapa dhe objektiva të përmendura më lart, të cilat janë të rëndësishme për rritjen e cilësisë së mësimdhënies, zhvillimin e stafit, lidhjen me komunitetin dhe përmirësimin e performancës së përgjithshme të fakultetit.

Si dekan i ardhshëm pa kursyer veten do të angazhohem në mbarëvajtjen e Fakultetit si dhe të të gjithë të punësuarve brenda tij. Vetëm në këtë mënyrë, pra me një angazhim të madh dhe të përbashkët mendoj se do të mund të arrijmë drejt majave të suksesit.

Nëse Këshilli Mësimor Shkencor i Fakultetit Juridik mbështet këtë program dhe më zgjedh mua si dekan, unë jap fjalën se do ta kryej detyrën me ndershmëri, ndërgjegje, përgjegjësi dhe vetëm në interes të Fakultetit Juridik.

**Kandidati për dekan**

**Prof. inord. Dr. Argëtim Saliu d.v.**

**Shkup, 14.11.2023**



**PROGRAMI I PUNËS SË KANDIDATES PËR DEKAN NË  
FAKULTETIN EKONOMIK PRANË UNIVERSITETIT “NËNË  
TEREZA” NË SHKUP**

Nga Prof. Inord. Dr. Bukurie Imeri- Jusufi

Nëntor 2023

Shkup

## Përmbajtja

<b>Hyrje .....</b>	<b>18</b>
<b>1. Misioni dhe vizioni .....</b>	<b>19</b>
<b>2. Programi i punësi Fakultetit Ekonomik për vitet 2023-2026.....</b>	<b>19</b>
<b>3. Qëllimet e programit.....</b>	<b>20</b>
<b>4. Studime cilësore .....</b>	<b>22</b>
<b>5. Studentët dhe stafi akademik.....</b>	<b>22</b>
<b>6. Hulimtim bashkëpunues që ofron zgjidhje.....</b>	<b>23</b>
<b>7. Mbështetja e zhvillimit rajonal dhe prania në qendrat rajonale.....</b>	<b>23</b>

## **Drejtuar Profesorëve dhe studentëve të Këshillit Mësimor Shkencor të Fakultetit Ekonomik**

### **Hyrje**

Ndodhemi në rrethinë dinamike ku çdo ditë duhet të përshtatemi në kushtet e reja të krijuara prandaj edhe të gjitha përpjekjet do të jenë që në plan program të jenë të shprehura idetë dhe inovacionet të cilat i propozoj për zhvillimin e Fakultetit Ekonomik për tre vitet e ardhshme akademike si një nga Fakultetet më të reja në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup. Programi i paraqitur përpiqet të reflektojë kapacitetet aktuale si dhe dëshirat dhe ambiciet për rritjen e mëtutjeshme. Duke pasur parasysh që të gjithë si komunitet akademik me punën dhe përpjekjet tona e determinojnë funksionimin dhe zhvillimin e Fakultetit Ekonomik, vlerësoj se përparimi i mëtutjeshëm i Fakultetit varet nga të gjithë ne, në mënyrë të vazhdueshme e vendos theksin tek funksionimi në rrugë ekipore gjë e cila është e potencuar edhe në këtë plan trevjeçar.

Zbatimi i planit do të stimuloj stafin akademik përveç realizimit të misionit të mësimdhënies edhe të nxisë rritjen e mëtutjeshme të veprimtarisë kërkimore shkencore, duke publikuar në revista shkencore ndërkombëtare, pjesëmarrjen në konferenca shkencore organizim të konferencave shkencore, për të arritur gradat shkencore dhe titujt akademik, si dhe përgatitjen e botimeve për të pasuruar krijimtarinë shkencore dhe për të mbuluar fushat studimore, në kuadër të fushave dhe problemeve ku literatura e deritashme nuk është e mjaftueshme dhe disa probleme nacionale nuk janë trajtuar deri tash. Si fakultet i ri dhe më pak i njohur është i nevojshëm ndërkombëtarizimi i fakultetit, që është një nga prioritetet kryesore dhe sidomos zhvillimi i Fakultetit Ekonomik si një arenë ku diskutohen e promovohen debate të rëndësishme publike mbi situata dhe dukuri aktuale.

Transparenca dhe bashkëpunimi kolegjal do të jetë një nga objektivat kryesore gjatë mandatit trevjeçar, pranimi i vërejtjeve dhe dallimeve por dhe përkrahjes së pakushtëzuar. Marr përgjegjësi që ky plan të kontribuojë në rritjen e Fakultetit Ekonomik dhe Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, institucion i cili që nga fillimi u ndërtua me përpjekjet tona të përbashkëta si nevojë për të pasur një fakultet që do të përgatiti gjenerata të reja të gatshme për tregun e punës në ditën e sotme dhe në të ardhmen.

Me respekt,

Dr. Bukurie Imeri- Jusufi- Prof. Inordinar d.v.



Në bazë të nenit 115 të Ligjit për Arsimin e Lartë (Gazeta zyrtare e RM-së, nr.82/18) dhe në pajtim me nenin 238 paragrafi 6 të Statutit të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, kandidati Inord. Prof. Dr. Bukurie Imeri-Jusufi propozon këtë:

Program për punë të dekanit të Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, në periudhën e mandatit 2024-2027

## **1. Misioni dhe vizioni**

Misioni dhe vizioni i Fakultetit Ekonomik pranë Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup, është tu përgjigjet nevojave të shoqërisë për të plotësuar mungesën e kuadrove në fushat ekonomike, specialistëve të ekonomisë, si dhe kuadrove të arsimit të lartë. Në këtë kontekst Fakulteti Ekonomik pranë UNT-së është dhe do të jetë në hap me avancimin e arsimit të lartë si dhe në kontinuitet do ti përkushtohet zhvillimit të mësimdhënies në mënyrë bashkohore, poashtu vëmendje e veçantë do u kushtohet proceseve hulumtuese dhe shkencore. Për të arritur qëllimet e caktuara Fakulteti Ekonomik duhet të veproj si qendër e zhvillimi të karrierës, të përgatitjes profesionale, përgatitjes deridiplomike, përgatitjes master, pse jo edhe organizimit të studimeve të doktoraturës, dhe të gjithë këtë synojmë ta arrijmë në bashkupunim me fakultetet e ngjashëm në vend dhe jashtë vendit. Fakulteti Ekonomik do të jetë i hapur dhe i përkushtuar për të gjithë studentët që do të trajtohen në mënyrë të barabartë në bazë të meritokracisë. Do të nxisim zhvillim e mendimit kritik dhe kreativ te studenët dhe te stafi akademik, me qëllim që të kontribuojnë në zhvillimin e sistemit ekonomik në RMV.

- Programet studimore deridiplomike që janë aktiv në kuadër të Fakultetit Ekonomik janë:
  - Financa dhe kontabilitet;
  - Marketing dhe menaxhment;
  - Dogana, shpedicion dhe sigurime.
  
- Programet studimore pasdiplomike që janë aktiv në kuadër të Fakultetit Ekonomik janë:
  - Financa dhe kontabilitet, master një vjeçar dhe dy vjeçar.

Synimi jonë është që në të ardhmen përveç programeve studimor ekzistuese të akreditojmë edhe programe të tjera atraktive nga cikli i parë dhe i dytë si dhe programe të tjera specializuese.

## **2. Programi i punësi Fakultetit Ekonomik për vitet 2023-2026**

Arsimimi është konsideruar gjerësisht si një instrument udhëheqës i rritjes ekonomike nëpërmjet kontributit të tij në ndërtimin e kapaciteteve të kapitalit human. Përfitimet nga arsimi nuk shihen vetëm për individin e shkolluar, por edhe për ekonominë si një tërësi. Fakulteti Ekonomik në Universitetin "Nënë Tereza" - Shkup i përcjell

ndryshimet në mjedis dhe me aktivitetet e tij u përshtatet kërkesave që dalin nga këto ndryshime. Përballë sfidës së ofrimit të kurrikulave aktuale, moderne dhe cilësore, që është edhe një synim strategjik, ky institucion i arsimit të lartë i përgjigjet me sukses sfidave të ekonomisë së re, duke dhënë kështu një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin e vendit. Roli i sektorit financiar, kontabël dhe bankar po ndryshon. Se si dhe sa shpejt do të ndodhin këto ndryshime do të varet kryesisht nga përgjegjësia profesionale, dhe kryesisht nga ne si individë. Vetëm ajo shoqëri, e cila do të kuptojë me kohë se burimet njerëzore të arsimuara cilësore janë forca e vetme lëvizëse e zhvillimit të ardhshëm, do të jetë në gjendje të përballet me sfidën që sjell ky mijëvjeçar. Supozohet se do të ketë një nevojë në rritje për personel të arsimuar nga këto fusha, sepse shoqëria ka filluar të kuptojë nevojën për funksionim efikas në këto fusha. Roli i arsimit ka një karakter kompleks, sepse ndryshimet e shpejta kërkojnë multi-arsimim për ekspertët e ekonomisë, i cili tashmë po bëhet i pashmangshëm. Prandaj dhe plan programi i Fakultetit Ekonomik është në përputhje me planin strategjik të Universitetit Nënë Tereza, dhe mbështet arritjen e objektivave të tij në fakultet dhe shoqëri, duke marrë parasysh botën në ndryshim. Plani synon të përcaktojë drejtimit e zhvillimit dhe mund të plotësohet nëse është e nevojshme. Fakulteti gjithashtu merr parasysh Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Republikën e Maqedonisë së Veriut për të lëvizur drejt qëllimeve të përcaktuara në planin strategjik.

### **3. Qëllimet e programit**

Pjesëmarrja në bashkëpunimin hulumtues ndërkombëtar si një partner i fortë na lejon të rrisim transferimin e njohurive në shoqërinë tonë dhe të kontribuojmë në zgjidhjen e sfidave globale. Gjithashtu do të ndihmojë në sjelljen e burimeve shtesë për fakultetin nga programet e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe për të vazhduar më tej në kohë. Nga ana tjetër, trupi studentor ndërkombëtar rrit qarkullimin e njohurive dhe përvojës përtej kufijve, kulturave dhe tregjeve globale.

Fakulteti Ekonomik do të jetë lidhja e drejtpërdrejtë mes partnerëve të tij të bashkëpunimit qofshin nga sfera akademike apo biznesore. Bashkëpunimi me universitetet dhe programet më të mira të huaja për të evoluar dhe përshtatur ndaj ndryshimeve së bashku. Studentët ndërkombëtarë gjithashtu ndihmojnë në shkëmbimin e njohurive dhe përvojave të ndryshme në Maqedoninë e Veriut dhe në këtë mënyrë përshpejtojnë zhvillimin e ekonomisë dhe rritjen e mirëqenies sociale.

Do të mundohemi të kemi programe studimore dhe hulumtime në gjuhët zyrtare të vendit, po ashtu edhe në gjuhën angleze, me qëllim që të sigurojmë mësimdhënie cilësore, kërkime shkencore cilësore, si dhe studentë nga rajoni dhe bota. Në mësimdhënie dhe kërkime, do të angazhohemi për një bashkëpunim më aktiv dhe më të fokusuar me universitetet mirë të ranguar rajonale dhe botërore, si dhe me partnerët e vendit dhe të huaj nga sektori biznesor. Për të arritur objektivat e fakultetit dhe të universitetit do të mundohemi të krijojmë bashkëpunim edhe me staf të jashtëm dhe vendas ekspertë në fusha të veçanta, poashtu duke përkrahur edhe motivuar stafin e

fakultetit për të qenë pjesëmarrës në projekte dhe aktivitete të ndryshme si burime shtesë të financimit dhe të ngritjes në karrierë. Do të nxisim gjithashtu bashkëpunimin me fakultetet e tjera të universitetit, me qëllim të krijimit të programeve studimore interdisciplinare, mbajtjen e punëtorive të ndryshme së bashku etj.

Fakulteti Ekonomik do të jetë një njësi që frymëzon anëtarët e saj, partnerët dhe shoqërinë, do të promovoj një mjedis që nxit zhvillimin dhe bashkëpunimin ndërmjet punonjësve duke pasur parasysh klimën organizative që ekziston në fakultet. Si njësi, do të jemi të përqendruar tek faktori njeri dhe do të vlerësojmë zhvillimin personal profesional, gjithashtu do të bashkëpunojmë me njësi dhe organizata akademike dhe profesionale për shkëmbim të përvojave të ndryshme.

Të jesh dekan i Fakultetit Ekonomik është prestigj, por edhe obligim dhe përgjegjësi për shkak se si i pari ndër të barabartitë duhet patur aftësi komunikuese dhe menaxhuese, prandaj do të mbështesim zhvillimin e aftësive menaxheriale dhe drejtuese dhe përhapjen e një mendësie krijuese, transparente dhe sipërmarrëse në mesin e stafit. Për të arritur përvojën e duhur nga të gjithë antarët e KMSH-së do të delegojmë detyra dhe përgjegjësi edhe anëtarëve të tjerë që të mundën të jenë vendimmarrës në vendimet e caktuara, prandaj ne do të mbështesim prezantimin e modeleve të ndryshme të menaxhimit dhe rotacionit në njësinë akademike, programeve dhe projekteve. Zhvillimi i modeleve të financimi që mbështesin arritjen e objektivave të performancës dhe bashkëpunimin midis njësive akademike dhe fushave kërkimore. Si fakultet i ri kemi edhe mungesë të stafit, prandaj do të fokusohemi më shumë në sigurimin e një gjenerate të re të stafit akademik dhe të zgjedhim stafin në baza meritokracie, të udhëhequr nga nevojat e fushave të studimit dhe kërkimit. Do të përkrahim dhe inkurajojmë pjesëmarrjen e punonjësve në programet e trajnimit dhe mentorimit në universitet, në Maqedoninë e Veriut dhe jashtë saj. Do të rrisim dhe forcojmë punën e rrjetit të studentëve (Alumnive) si në Republikën e Maqedonisë së Veriut ashtu edhe më gjerë, duke njohur dhe frymëzuar të diplomuarit tanë si ambasadorë të Fakultetit Ekonomik të Universitetit “Nënë Tereza” në Shkup. Bashkëpunimi me nxënësit e shkollave të mesme dhe shkollat profesionale, do të jetë parësor, për ta bërë më të lehtë kalimin e tyre nga shkolla e mesme në universitet, si dhe përshtatjen e tyre me jetën studentore, bashkëpunim me komunitetet partnere, palët e interesuara dhe grupet e synuara të fakultetit, duke u ofruar atyre një platformë zhvillimi, mundësi bashkëpunimi, seminare të përbashkëta, konferenca dhe ngjarje të tjera që zhvillojnë dhe zgjerojnë rrjetin, të gjithë ata që do të kërkojnë ndihmë dhe mbështetje nga Fakulteti Ekonomik ( organizimin e garave dhe seminareve të ndryshme, si dhe përgatitjen e nxënësve për provimet e maturës)

Aktiviteti dhe suksesi në promovimin e fakultetit dhe universitetit, si dhe ndërveprimin social ndërmjet njësive, për shembull, duke organizuar ditët e hapura të fakultetit, shënimin e datave të rëndësishme të fakultetit, tryezave, konferencave apo duke festuar të arriturat tona, do të jenë garancia e përparimit tonë institucional.

#### **4. Studime cilësore**

Studentët e Fakultetit Ekonomik do të jenë të motivuar për të zhvilluar përvoja të reja mësimore dhe kulturore do të jenë aktivë në shoqëri dhe të jenë kontribuues në procese të ndryshme shoqërore. Aktiviteti qendror i fakultetit do të jetë mësimdhënia bazuar në konceptet bashkohore, në hulumtim, inspirim dhe mësim gjatë gjithë jetës, përmes programeve të ndryshme për mësim të grup moshave të ndryshme. Aftësitë e mësimdhënies, metodat dhe procesi arsimor të jenë të bazuara në profesionalizëm, cilësi të lartë dhe hulumtim që do të jetë arsyeja ku edhe do të jemi më tepër të fokusuar. Do të punojmë fort që mësimdhënia dhe mësimnxënia të vlerësohen me qëllim që studentët dhe stafi i fakultetit të kenë një emër të mirë në mesin e të gjithë studentëve, komuniteteve të ndryshme dhe shoqërisë. Kur zhvillojmë mësimdhënie dhe hulumtim, marrim parasysh tendencat gjithëpërfshirëse që do të thotë vendosjen e një relacioni në mes rrugëve individuale të të mësuarit, kurrikulave të mësimdhënies, formave të reja të digjitalizimit, etj.

Zhvillimi i kurrikulave dhe programeve të trajnimit rrjedh nga nevoja për një zhvillim të mëtejshëm kombëtar dhe ndërkombëtar, duke qenë pro aktiv, inovativ dhe pionier nëpërmjet universitetit. Sigurim të të gjitha fushave dhe studimeve deridiplomike dhe master të kenë kurrikulë të zbatueshme, cilësore dhe atraktive në gjuhën shqipe/maqedonase/angleze.

Aplikim të metodave moderne të të mësuarit, duke përfshirë format digjitale të studimit, dhe fokusohemi në sigurimin e një mjedisi më të mirë, frymëzues dhe motivues për studentët.

Mbështetje të mësimit interaktiv dhe zhvillimit të komuniteteve të të mësuarit brenda dhe ndërmjet njësisive. Do të mundohemi që përveç formimit teorike të kemi edhe formim praktik, karakteristikë e një universiteti/fakulteti kërkimor.

Do të mundohemi që fakulteti të ketë një rrjet të partnerësh nga sektori publik dhe privat, për të pasur mundësi të ndryshme trajnimesh për studentët dhe stafin, do të vlerësojmë mendimet e studentëve për ndryshime në realizimin e teorisë dhe praktikës.

Ndër qëllimet kryesore do të jetë edhe rritja e numrit të studentëve në të dy ciklet si dhe në studimet e specializimit.

#### **5. Studentët dhe stafi akademik**

Rruga e zhvillimit personal të studentit dhe zhvillimi i aftësive të përgjithshme si nëpërmjet studimeve ashtu edhe përmes praktikës do të jenë parësore, duke u munduar që me realizimin e praktikës në sektorin real, ta ndejnë nevojën e përgatitjes për tregun e punës. Trajtimi grupor, partnerial, e sidomos individual i studentëve, me qëllim të arritjes së suksesit në të mësuarit dhe të aftësuarit profesional..

Shpesh herë studentët tonë hezitojnë të kalojnë një pjesë të studimeve në universitete të tjera prandaj do të inkurajojmë studentët që të kalojnë një pjesë të

studimeve të tyre në një universitet të huaj, por njëkohësisht edhe do të mirëpresim studentë nga universitete të tjera nga rajoni apo nga Evropa. Do të zhvillojmë partneritete që mbështesin mobilitetin e të mësuarit, duke përfshirë mobilitetin e të mësuarit dixhital si dhe do të mbështesim studentët të bëjnë zgjedhjen në këtë drejtim. Qëllimi jonë do të jetë të përfshijmë praktikantë, ekspertë nga praktika, demonstratorë dhe profesionistë të dëshmuar që të ofrojnë kontribut në procesin e mësimdhënies, qoftë nëpërmjet honorarëve apo mësimit klinik vullnetar, në të gjitha programet studimore.

## **6. Hulumtim bashkëpunues që ofron zgjidhje**

Mjedisi dinamik, rritja dhe zhvillimi i shpejtë i teknikës dhe teknologjisë, rinxhinierimi i proceseve, menaxhimi i sistemeve të biznesit po bëhen më komplekse, duke kërkuar krijimin e personelit të përshtatshëm që mund të përballojë me sukses këto ndryshime dhe të kontribuojë në zhvillimin ekonomik të vendit. Aftësimi i studentëve për të marrë njohuri konkrete dhe të zbatueshme dhe një nivel të lartë të të kuptuarit të një sërë çështjesh në fushën e marketingut dhe menaxhimit, duke vendosur një vizion dhe mision realist, politika dhe strategji për të qenë në gjendje të zhvillojnë aftësitë e analizës mjedisore, të opinionit kritik. mes studentëve, si dhe aftësitë analitike për zgjidhjen e problemeve. Në Fakultetin Ekonomik, ne do të përqipemi për ndërtimin e një botëkuptimi të ri të mësimdhënies, mësimdhënies dhe hulumtimit shkencor të orientuar nga kërkimi dhe të diktuar edhe nga kushtet e AI. Do të vlerësojmë studiuesit dhe kërkimin, ku do të nxisim zhvillimin e një brezi të ri të stafit akademik të cilët do të kombinojnë mësimdhënien me kërkimin shkencor dhe do të kthejnë studentët në auditorë si vende kërkimi në të gjitha fushat shkencore. Në kërkimin dhe zhvillimin, ne do të fokusohemi në sfidat e ndryshme shoqërore dhe ekonomike, duke kombinuar disiplina të ndryshme akademike për të ofruar alternative dhe zgjidhje për problem të ndryshme duke i përfshirë në mënyrë aktive partnerët, burimet dhe financuesit e ndryshëm të kërkimit.

Programi synon të përgatisë staf akademik të së ardhmes, për nevojat e fakultetit dhe njësive tjera të Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, kuadro që do të mbulojë pjesën më të madhe të nevojave të kësaj fushe në vend dhe jashtë, duke fuqizuar kapacitetet institucionale të departamenteve të cilat mbulohen me profile ekonomike. Rritja e punësimit të të diplomuarve tanë të ardhshëm në fushën e marketingut, financave dhe ekonomisë menaxheriale përmes një oferte të gjerë programesh studimi, të orientuara në nevojat e tregut dinamik të punës, dhe duke prodhuar burime njerëzore cilësore, të gatshme për t'iu përgjigjur sfidave ekonomike të së ardhmes.

## **7. Mbështetja e zhvillimit rajonal dhe prania në qendrat rajonale**

Për të shfrytëzuar potencialin kërkimor të fakultetit, për të krijuar partneritete dhe për të tërhequr më shumë fonde, Fakulteti Ekonomik do të jetë pjesëmarrës në aktivitete dhe projekte të ndryshme që do të mbahen në të gjithë RMV-në dhe do të jetë

bashkëpunëtorë me sektor të ndryshëm, pjesëmarrës në edukimin financiar dhe ekonomik të popullatës së Republikës së Maqedonisë së Veriut, krijues dhe përkrahës i strategjive të ndryshme për të rinjtë, strategjive të zhvillimit ekonomik etj

Kandidati:

Dr. Bukurie Imeri- Jusufi- Prof. Inordinar d.v.

## **PLATFORMË PUNE**

**nga prof.dr. Mustafa Ibrahim**

për pozitën e dekanit në Fakultetin e Shkencave Humane  
në Universitetin “Nënë Tereza” në Shkup

### **I. QËLLIMET E PËRGJITHSHME**

Në qoftë se më besohet posti i dekanit, jam i gatshëm të punoj në aktualizimin e misionit kryesor të fakultetit, i definuar në strategjitë zhvillimore të UNT-së, për të arritur rezultate edhe më të mira në aktivitetet hulumtuese – shkencore dhe në mësimdhënie.

- Përveç profesionalizmit, do të merrem edhe me etikën dhe përgjegjësinë në punënarsimuese dhe hulumtuese.
- Do të promovoj idenë e sundimit të ligjit, hapjes para publikut dhe do ta rris bashkëpunimin me bashkësitë shoqërore, institucionet akademike të vendit dhe ato ndërkombëtare.
- Do të promovoj vlerat intelektuale për të cilat janë përcaktuar institucionet e vendit dhe ato ndërkombëtare.
- Respektimi i veçantive kombëtare dhe rajonale dhe specifikat që kanë gjuhët në shoqëritë multikulturore.
- Nxitja e klimës së mirëkuptimit dhe solidaritetit midis të punësuarve dhe studentëve
- Do të promovoj dialog dhe bashkëpunim të dyanshëm si një model i zgjidhjes së problemeve ndërkolegiale dhe do të kërkoj nga secili anëtarë i Këshillit të Fakultetit, se në këtë aspekt duhet ta tejkalojnë vetveten, duke u bazuar edhe në shembullin tim dhe në autoritetin që ka dekan, duke përdorur të gjitha mjetet e lejuara.
- Do të kërkoj që çdo anëtar i fakultetit të merr edhe përgjegjësinë e vet për të kontribuarnë qëllimet e përbashkëta të Fakultetit.

**Në vazhdim do të promovoj vizionin tim në rolin si dekan dhe menaxhimin me resurset dhe aktivitetet kryesore të Fakultetit.**

### **II. ORGANIZIMI I FAKULTETIT**

- Rritja e efikasitetit në punën organizative dhe efektiviteti i të gjitha shërbimeve
- Harxhime optimale të mjeteve financiare në përputhje me planet e fakultetit
- Krijimi i qendrave të reja me profile të dukshme të kuadrit mësimor
- Përmirësimi i vazhdueshëm dhe zhvillimi i resurseve materiale të Fakultetit.
- Formimi i një Këshilli për marrëdhënie me shkollat, drejtorët dhe profesorët lëndor

## **1. Kuadri arsimor**

Stafi mësimdhënës është pa dyshim resursi kryesor i Fakultetit, që si shqetësim kryesor kasigurimin e numrit të mjaftueshëm dhe të kualifikuar të mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve.

Do të rekomandoj krijimin e një politike të veçantë zhvillimi për personelin akademik që ka përsynim:

- Implementimi i strategjive motivuese për personelin akademik
- Njohuri dhe praktika të reja në mësimdhënie që do të mundësojnë rritje dhe prosperitet
- Përfaqësim të barabartë të të gjithë të punësuarve nëpër komisionet kryesore të fakultetit.
- Paraqitja e projekteve në kuadër të katedrave dhe qendrave hulumtuese
- Angazhimi i profesorëve ekspert nga shkencat kompjuterike për laboratorin linguistik
- Mbështetja e qëndrimeve studimore në vend dhe jashtë vendit, organizimin e konferencave, botime të veçanta etj.
- vazhdimi i subvencionimit të mësimin të gjuhëve për të punësuarit.

## **2. Programet akademike**

- Qëllimi strategjik 1: Rishikimi i plan – programeve mësimore
- Qëllimi strategjik 2: Mbajtja e mbledhjeve tematike të Këshillit Mësimor
- Qëllimi strategjik 3: Studime të reja që janë të lidhura me nevojat e vendit dhe jashtë
- Qëllimi strategjik 4: Ndjekja e progresit të studentëve deridiplomik dhe të masterit.
- Qëllimi strategjik 5: Hapja e mësimin gjatë tërë jetës në përputhje me nevojat e shtetit, rajonit ose qytetit

## **3. Menaxhimi me studentët**

Studentët nuk do të jenë më shikues pasiv, por pjesëmarrës aktiv, jo vetëm në Këshillin e Fakultetit, por edhe në trupat dhe komisionet tjera të fakultetit, që mund ta risin renomenë e fakultetit.

- Ngritja e vazhdueshme të cilësisë së studimit
- Ndjekja e progresit të studentit, por edhe vërejtjet dhe sugjerimet e tyre
- Kyçja në punën shkencore dhe artistike (shpërblime : nga rektori, dekani,
- Përkrahja e aktiviteteve studentore: arsimore, kulturore, sportive
- nxiten për të marrë pjesë në programet ERASMUS dhe aktivitete tjera mobiliteti.
- Të marrin pjesë përfaqësuesit e studentëve në çdo mbledhje të Këshillit



#### **4. Hulumtime**

Ne do të rekomandojmë formulimin e prioriteteve kërkimore, duke formuar grupe kërkimore.

- Krijimi i grupeve për hulumtime shkencore nga fushat përkatëse të stafit dhe aplikim për grante
- Kyçja e kandidatëve të masterit dhe doktoratës në projekte dhe bursa, në vend dhe jashtë.
- Inkurajimi për mobilitet dhe specializime postdoktoriale
- Formimin e grupeve të përbashkëta kërkimore me hulumtuesit nga universitetet e huaja
- Do të insistoj në veprimtarinë botuese n; FSHH, botime personale (libra, doracak etj.)
- Në faqen e fakultetit në Facebook do të prezantojmë të gjitha aktivitetet mujore që ndodhin në fakultet

#### **5. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Një nga synimet e FSHH, duhet të jetë rritja e bashkëpunimit ndërkombëtar.

- Vazhdimi i nënshkrimit të marrëveshjeve bilaterale midis fakulteteve dhe instituteve simotra
- Konkurimi në projektet ndërkombëtare në fushën e arsimit
- Bashkëpunim partneriteti mes universitetet homologe në rajon, Evropë dhe më gjerë
- Zgjerimin e institucioneve partnere në programin ERASMUS.
- Krijimi i potencialit për pranimin e studentëve të huaj në kuadër të ndërrimit të studentëve,
- Të intensivohet ndërrimi i mësimdhënësve midis fakulteteve të partneritetit dhe institucioneve

#### **6. Organizimi, Menaxhimi dhe Planifikimi**

Gjatë mandatit tim si dekan i Fakultetit të Shkencave Humane (FSHH), unë do të përpiqem të punoj dhe kontribuoj për këto 4 çështje të rëndësishme:

##### **I. Ngritja e cilësisë në kuadër të fakultetit**

1. Ngritja e nivelit të mësimdhënies, hulumtimit dhe të shërbimit të Universitetit duke mbajtur dhe punësuar staf të përzgjedhur.

2. Përgatitja e shkencëtarëve të rinj, formimi i specialistëve të lartë dhe të ku prioritete më të larta do të jenë avancimet akademike, kërkimore dhe hulumtuese
3. Të krijojë, të transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet me anë të mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe përmirësim të shërbimeve;

## **II. Implementimi i rekomandimeve nga vëzhguesit e ndryshëm**

4. Implementimi i rekomandimeve dhe sugjerimeve të vëzhguesve të jashtëm, ku kryesisht propozohen programe të reja, si në ciklin deridiplomik ashtu edhe në ciklin pasdiplomik.
5. Do të kontribuoj në rritjen e standardeve të demokracisë e të qytetërimit të shoqërisë dhe në përgatitjen e të rinjve për një shoqëri të tillë.
6. Të ndihmojë zhvillimin ekonomik në nivel kombëtar dhe rajonal nëpërmjet punësimeve të shpejta, që mund të ofrojnë programet tona.

## **III. Reforma në kuadër të FSHH**

7. Në mandatin tim do të bëja rirreshtime në kuadër të fakulteteve në FSHH. Do të themeloja Qendrën e gjuhëve, në kuadër të FSHH dhe së bashku do të punonim para se gjithash për të zvogëluar harxhimet dhe për të rritur efikasitetin, profesionalizmin dhe cilësinë e mësimdhënies dhe mësimnxënies, qoftë në lëndët profesionale qoftë në ato të mbajtjes së kurseve.
8. Me hapjen e Qendrave për çdo program studimor të Gjuhëve Angleze, Gjermane, dhe përkthim Shqip/Maqedonisht/Anglisht/Gjermanisht, të cilët do të luajnë edhe rolin e koordinatorëve.
9. Do t'i zbatoja dhe përfundoja të gjitha detyrat dhe obligimet e deritanishme jo vetëm duke i përfunduar, por do t'i qoja përpara, ku si prioritet do të ishin vazhdimi i procesit të rrjetëzimit të programeve tona në organizmat evropiane dhe botërore, të fakultetit dhe universitetit tonë.
10. Do të bëja përpjekje për avancimin e cilësisë në procesin edukativ, sidomos në atë pasdiplomike që duhet së shpejti propozohen, ku kemi disa vërejtje për tjerat fakultete nga vëzhguesit, por edhe nga bisedat me studentët, të cilët në disa çështje nuk janë të kënaqur. Për këto zbrazëtira do të bëj përpjekje të përmirësohen, avancohen me qëllim të rritjes së numrit në të gjitha grupet dhe programet e studimit në fakultetin tonë.
11. Të ofrojmë kushte që studentët të kenë mundësi për të përfituar nga arsimi i lartë gjatë gjithë jetës. Theks të posaçëm do të jetë lidhja e teorisë me praktikën, që nënkupton vizita të shpeshta të studentëve nëpër institucione relevante, qoftë brenda dhe jashtë shtetit.

12. Fakulteti edhe më tej do të bazohet në 4 programet në ciklin e parë: Gjuha angleze, gjuha gjermane, komunikimi ndërkombëtar dhe Përkthimi Shqip/Maqedonisht/ Anglisht/Gjermanisht, me tenencë zgjerimi edhe me një program krejtësisht të ri.
13. Do të ofrojmë studime njëlëndore dhe dylëndore në ciklin e parë të studimeve

#### **IV. Ndërkombëtarizimi i Fakultetit dhe Universitetit**

14. Të bëj ndërkombëtarizimin e fakultetit duke e anëtarësuar FSHH-në në organizma dhe asociacione ndërkombëtare lidhur me gjuhët, letërsinë dhe përkthimin
15. Në këtë aspekt do të ishte mirë të fillojmë me studimet e gjuhëve dhe kulturave evropiane, sidomos në ciklin e dytë, si përgatitje për anëtarësimin e shteteve ballkanike në Bashkimin Evropian, ku gjuha shqipe dhe maqedonase pritet të jenë gjuhë zyrtare. Interesante do të ishin Studimet e përkthimologjisë Shqip-maqedonisht-anglisht- gjermanisht. Të rëndësishme edhe për nivelin lokal.

#### **7. Infrastruktura/Hapësira dhe Pajisjet**

Fakulteti i FSHH ka një strukturë të përshtatshme dhe shumë funksionale për zhvillimin e programeve të tanishme dhe të ardhme. Ka mjaft dritë natyrale dhe hapësira komode. Sallat janë të përshtatshme dhe të përgatitura për të ardhmen, por FSHH i mungon një laborator lingistik, për analiza të ndryshme gjuhësore që mund të shfrytëzohet nga të gjitha katedrat , në të gjitha ciklet e studimit.

FSHH i nevojitet edhe krijimi i një Sistemi i Menaxhimit të Mësimit ( LMS) si pajisje komplementare për mësimet sy me sy. Ky sistem do të përmirësonte komunikimin mes studentëve dhe ligjëruesve dhe gjithashtu do prezantonte mësim inventiv dhe metodologji të mësimdhënies. LMS do ishte interesante për komunikim të mirë dhe punë koordinuese mes dhe brenda degëve, dhe po ashtu për shkollat ku studentët ndjekin praktikën e tyre të mësimdhënies, pasi do të shërbente si instrument komunikimi dhe informacioni për studentët dhe tutorët në këto qendra arsimit.

Do të iniciojmë krijimin e ueb faqes të fakultetit. Do të instalojmë një ose dy TV-monitorë për tu ofruar studentëve informata orari dhe shërbime tjera.

#### **8. Menaxhimi i cilësisë**

Më qëllim të zhvillimit e një kulture të cilësisë, duhet të ngritet një plan i veçantë veprimi dhe indikatorët e rezultateve të pritura.. Ne rekomandojmë implementimin e rrethit të sigurimit të cilësisë: planifikim-implementim-vlerësim-përmirësim. Rrethi i cilësisë së brendshme duhet të përfshijë të gjitha palët: studentët, stafin akademik dhe administrativ dhe ish studentët. Nuk ka dëshmi për feedback të stafit apo ish studentëve.

Të kontaktohen ish studentët dhe që ata të luten për feedback rreth kurseve të studimeve që ata i kanë kaluar. Ata do jenë në gjendje të krahasojnë nevojat e punës në jetën reale dhe vlerësojnë rëndësinë e kualifikimeve të tyre në punë. Një feedback pyetësori do të përdorim edhe për anëtarët e personelit akademik dhe administrativ, që duhet të përfshijë pyetje për ngarkesën e punës, ambientin e punës dhe mundësitë për zhvillim dhe njohje të mëtejme profesionale.

## **9. Veprimtaria botuese**

Fakulteti në periudhën e ardhshme ti jep rëndësi edhe botimeve, duke rritur veprimtarinë e vet botuese. Të përkrahen librat profesional, doracakët, monografitë dhe përmbledhjet e punimeve. Me rëndësi të tërheqim sa më shumë autorë nga jashtë të marrin pjesë në borde redaktuese dhe botime. Duhet sa më shpejtë të zgjedhim çështjen e indeksimit të Përmbledhjeve të punimeve në publikimet relevante ndërkombëtare. Në veprimtarinë botuese e rëndësishme është të mbrohen të drejtat e autorit.

## **10. Efektet rajonale**

**Qëllimi strategjik 1:** Forcimi i aktiviteteve të përgjithshme të FSHH dhe ndikimi pozitiv në ngjarjet në vend, por edhe më gjerë

**Qëllimi strategjik 2:** Intensifikimi i bashkëpunimit me sektorin publik dhe privat

## **11. Prioritetet**

Në mandatin tim do të orvatem të jem:

- Udhëheqës pozitiv i ekipit, nxitës dhe i hapur, llogaridhënës dhe me etikë kolegjiale;
- Aftësi për të mbajtur lidhje me menaxhmentin e lartë dhe me departamentet tjera të fakultetit në lidhje me strategjinë dhe përgjegjësitë institucionale;
- Menaxhim efektiv dhe administrim të procedurave dhe funksioneve akademike të bazuara në dëshmi, akademikisht të arsyeshme dhe vendimmarrje të qëndrueshme;
- Menaxhim efikas të burimeve, duke përfshirë stafin dhe menaxhim të performancës në nivel të fakultetit,
- Mësimdhënës dhe hulumtues model, si dhe udhëheqës në përmirësimin e të nxënit dhe mësimdhënies, që fuqizon stafin dhe studentët;
- Lidhje pro-aktive në mes të palëve të interesuara nga jashtë dhe të brenda,
- Mbrojtës i sistemeve të universitetit dhe përkrahës i standardeve të universitetit dhe lirisë akademike.

Prof.dr.Mustafa Ibrahim d.v.

Shkup, 23.11.2023